



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 61 paragrafi 61.1. pika (b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. pika (d) të RREGULLORËS NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 07.10.2025 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Kag – Asphalt Company” ShPK nga PRIZRENI, bie këtë:

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Kag – Asphalt Company” ShPK nga PRIZRENI e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës së prokurimit me datën 07.10.2025 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-25-8181-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-25-010-5-2-1 me titull: “Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur, Pasha dhe Demirci në Mamushë”

II

Anulohet njoftimi për pezullim të procedurës së prokurimit i datës 07.10.2025 pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Kag – Asphalt Company” ShPK nga Prizreni me datë 07.10.2025 përmes platformës elektronike të prokurimit, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit në lidhje me njoftimin e kontratës dhe kriterëve të kërkuara për procedurën e prokurimit në fjalë nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushës për projektin me titull: “Rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës Kultur, Pasha dhe Demirci në Mamushë”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me vëmendje, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 28 dhe 69 të LPP-s. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim:

Pas shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të operatorit ekonomik ankues, Autoriteti Kontraktues konstaton se kriteret dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit janë të bazuara në natyrën e kontratës dhe në kërkesat teknike që sigurojnë realizimin e duhur të punimeve.

Ne si AK nuk kemi bërë shkelje të asnjërës dispozitë të lartcekur nga Operatori ekonomik sepse nuk kemi favorizuar dhe nuk kemi diskriminuar asnjë operator ekonomik. Operatori Ekonomik i cili ka bërë kërkesë për rishqyrtim e ka pasur mundësinë ligjore që të kërkoj sqarim për secilën pjesë të dosjes së tenderit deri me datën: **03.10.2025 ora 14:00** mirëpo nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

Pastaj lidhur me pretendimet për diskriminim apo kufizim të konkurrencës, në asnjë pjesë të dosjes së tenderit nuk janë përcaktuar marka, modele apo specifika që mund të favorizojnë operatorë të caktuar. Përkundrazi, të gjitha kërkesat janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme dhe të hapur, duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve të ndryshëm që posedojnë pajisje të krahasueshme dhe që përmbushin minimumin e kërkuar teknik.

Kërkesat për përfshirjen e inxhinierëve të profileve të caktuara (Hidroteknik, Inxhinieri Ambienti) dhe tekniket

3. a) Lidhur me kërkesën për teknik të ndërtimtarisë të certifikuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme inerte, kjo kërkesë është përfshirë në dosjen e tenderit në përputhje me standardet ligjore dhe rregulloret në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve, të cilat kërkojnë që çdo operator ekonomik që kryen punime ndërtimore të ketë staf të trajnuar për identifikimin dhe menaxhimin e çdo materiali potencialisht të dëmshëm apo inert që mund të rezultojë gjatë punimeve (si mbetje bituminoze, beton, apo materiale ndihmëse). Edhe pse në planifikim nuk parashihet sasi e madhe e mbetjeve të rrezikshme, kërkesa mbetet masë parandaluese dhe e detyrueshme për sigurinë dhe përputhshmërinë mjedisore, prandaj konsiderohet e arsyeshme dhe proporcionale me natyrën e punimeve.

b) Lidhur me kërkesën për punëtorë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri. Kjo kërkesë është vendosur në përputhje me legjislacionin e punës dhe të sigurisë në vendin e punës, me qëllim që operatori ekonomik të sigurojë zbatimin e masave parandaluese ndaj rreziqeve që mund të ndodhin gjatë punimeve inxhinierike (përdorim i makinerive, karburanteve, asfaltit të nxehtë, etj.).

Edhe pse punimet zhvillohen në ambient të hapur, prania e makinerive të rënda, materialeve djegëse dhe pajisjeve elektrike kërkon që një numër minimal i punëtorëve të jenë të trajnuar për reagim emergjent. Kjo kërkesë është pra masë e sigurisë dhe jo kufizuese, dhe është në interes të operatorit vetë për të garantuar mbrojtje dhe siguri gjatë realizimit të kontratës.

Punëtorët me përvojë pune pas diplomimit janë përcaktuar në përputhje me kompleksitetin e projektit, natyrën e terrenit dhe nevojën për garantimin e cilësisë së punimeve. Pjesët e projektit që përfshijnë sistemet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbrojtjes së mjedisit kërkojnë ekspertizë përkatëse, prandaj këto kërkesa nuk konsiderohen diskriminuese por proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 2 Lidhur me kërkesat për makineri dhe pajisje

Kërkesat për kapacitetet minimale të pajisjeve peshat, kapacitetet bartëse, llojet e mjeteve, etj., janë vendosur bazuar në llogaritjet teknike dhe nevojat faktike të realizimit të punimeve, me qëllim që të sigurohet efikasitet dhe cilësi gjatë ekzekutimit të kontratës. Autoriteti Kontraktues thekson se këto kërkesa nuk kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës, por përcaktimin e standardeve minimale teknike për operatorët që synojnë të kryejnë punime të kësaj natyre.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 dhe 6 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik, për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase dhe më ekonomike. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për paranë, pasi që do të rekomandojmë për kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët sikur është paracaktuar kushti për dhënie të kontratës i cili është “tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët” i paraparë në dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 pika 1.1. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që ky pretendim është i pa bazë pasi që ne, të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar dhe do ti trajtojm në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente deri në këtë fazë para hapjes së tenderëve, në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. Të gjitha dokumentet e procedurës të nevojshme janë ngarkuar në platformën në e-prokurim, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente apo se kemi diskriminuar ndonjë O.E.

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori

Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin komprometim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit të O.E. ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi AK-es ka përpiluar dosjen e tenderit dhe në aneksin nr. I ka paraparë specifikat minimale të kërkuara. Të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike dhe projekti ekzekutiv janë punuar nga kontraktuesi i cili ka hartuar këto specifikat në përputhje me standardet dhe ligjet e zbatueshme për ndërtimin. Të njëjtat i ka ndarë që të jenë të kuptueshme dhe se janë të sqaruara në detale. Nëse ka pasur ndonjë paqartësi O.E. ankues ka mundur që në afatin e paraparë të kërkojë sqarim duke përdorur Aneksi 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË. Andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit të O.E. ankues se AK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron, pasi që Autoriteti Kontraktues ka zbatuar në përpikëri nenin 69 të LPP-s me ç'rast duke ju referuar nenit 69 të LPP-s ka përcaktuar kërkesat minimale kualifikuese për pajisjet teknike të cilat duhet ti paraqet një O.E. për tu konsideruar i përgjegjshëm.

Në bazë të të gjitha fakteve të mësipërme, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim nuk janë të bazuara dhe se dokumentet e tenderit janë hartuar në përputhje me parimet e ligjit për prokurim publik, konkretisht proporcionalitetin, transparencën dhe konkurrencën e drejtë.

Si rrjedhojë, kërkesa për rishqyrtim e **“Kag – Asphalt Company” ShPK** refuzohet si e pabazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 08.10.2025

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë

